



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -X- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 30 NËNTOR 2023

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:15. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Refik Maloku, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Shkelzen Xhaferi, Spasojë Stefanoviq, Sylejman Mehulli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mungoj: Ali Januzi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 34 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-në adresim para kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, duke marr për bazë propozimin e qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe duke ju referuar aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, propozoj që të futet në rendin e ditës propozim-vendimi për faljen e obligimeve tatimore në pronën e paluajtshme në vlerë deri në 100 €, për vitin 2023 për të gjitha bizneset dhe ekonomitë familjare në Komunën e Vushtrrisë. Po ashtu kërkoj që të mos ketë ngritje të normave të tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2024 duke marr për bazë gjendjen e rënduar ekonomike të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se duke marr për bazë aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, tani është në kompetencën e kuvendeve komunale, që të marrin vendim për faljen e obligimeve nga tatimi në pronën e paluajtshme. Andaj ftoj të gjithë anëtarët e kuvendit që të përkrahin këtë propozim-vendim. Po ashtu përsëriti se tarifatat dhe normat tatimore duhet të mbeten të njëjtat me vitin e kaluar për shkak të gjendje që po mbretëron në Komunën e Vushtrrisë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –në emër të grupit kuvendar të LVV-së ceku se tani por edhe më herët e kanë përkrahur propozimin për faljen e obligimeve tatimore deri në 100 €, por tani

patëm një shkarje nga debati për rendin e ditës ku kryetari i komunën e propozoj këtë pikë për rendit ditë akoma pa ardhur tek rendi i ditës sigurisht për ta marrë autorësinë e këtij propozimi. Lidhur me propozim-vendimin për normat tatimore për vitin 2024 ceku se ka qenë rekomandim i KPF-së, që të sillen në kuvend normat e vjetra tatimore por që një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Për këtë kërkoj që kjo listë e normave të sillet deri në diskutimin e kësaj pike kur të vjen radha. Po ashtu edhe për pikat tjera të rendit të ditës nuk janë duke u respektuar rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa. Ndër të tjera nuk është përfillur rekomandimi për listën e pronave si dhe listën e punëtorëve të N.P.L. “Përparimi”. Në këtë kontekst kërkoj nga kryesuesja e kuvendit dhe sekretari si garantues i funksionimit të kuvendit që të merret me këto rekomandime të lëshuara nga KPF-ja.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –duke ju adresuar anëtarëve të kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë deklaroj: të nderuar anëtar të Kuvendit, përfaqësues të mediave, shoqërisë civile, përfaqësues të KFOR-it Të dashur qytetarë, Për plot 11 muaj me radhë, me shumë keqardhje kemi parë se si Komuna jonë vazhdimisht është renditur në fund të listave për menaxhimin e projekteve kapitale, ku deri në muajin nëntor Komuna e Vushtrrisë ka arritur të shpenzoj vetëm 16% të buxhetit për investime kapitale. Tani në muajin dhjetor, Kryetari paska zgjedhur që mos punën e tij përgjatë 11 muajve ta realizoj për një muaj të vetëm. Shpenzimi i buxhetit në këtë mënyrë është i dëmshëm dhe nuk ju sjell asgjë qytetarëve, përveç shpenzimit të buxhetit për punë të papërfunduara. Të jemi real, shumë më mirë Kryetari qëndron në shpenzimin e buxhetit për mallra dhe shërbime. Por edhe kjo nuk po ndodhë rastësisht, sepse kryetari tashmë ka filluar që përpos militantëve partiak, me kontrata t’i shpërblej edhe ish kolegët e tij nga Ministria e Arsimit. Këtë shqetësim Lidhja Demokratike e ka ngritur para disa ditëve, ku ka njoftuar qytetarët e Vushtrrisë se Kryetari i Komunës shpërblen shoqen e tij me 16000€ nga taksat e qytetarëve. Kërkojmë nga Kryetari që të na sjell raportet e punës për këtë kontratë. Gjithashtu ftojme organet e rendit që të hetojnë këtë kontratë. Shpërblimet nuk ndalen këtu, për më shumë se dy vite Kryetari shpërblen me kontrata për shërbime të veçanta edhe djalin e kryetares së bordit të Përparimit, ku i njëjti për tërë këtë periudhë merr pagë nga Komuna duke mos qenë fare në Kosovë. Me siguri Kryetari dhe PDK-ja kanë obligime të mëdha ndaj kësaj familje. Emërohet kryetare e Bordit të ndërmarrjes publike “Përparimi” në kundërshtim me ligjin, ngase ligji thotë që në këtë pozite duhet të emërohet një njohës i mirë i pasqyrave financiare dhe jo një person që ka përfunduar fakultetin e Gjuhës Angleze. Ky emërim nuk mjaftoj dhe kryetari shpërblej edhe të birin e Kryetares së bordit, edhe pse i njëjti nuk jeton fare në Kosovë. Po nga e njëjta familje, Kryetari shpërblen me kontratë për shërbime të veçanta edhe shefin e protokollit në Komunën e Vushtrrisë, i cili është përgjegjës për protokollin në organizime të Komunës, ku edhe atëherë kur na ftonit në organizime të Komunës nuk kishim as vende për tu ulur, por si duket tashme edhe për këtë keni bërë zgjidhje duke mos na ftuar fare nëse si opozite në asnjë organizim. Vizitat e shumta jashtë vendit nga ana e zyrtarëve dhe Komisioneve Komunale kanë ndikuar gjithashtu në shpenzim të buxhetit, por deri më sot nuk i kemi parë përfitimet e Komunës sonë nga këto vizita, ose a mund të na tregoni një përfitim të komunës nga gjithë këto vizita të kushtueshme jashtë vendi? Për çdo ditë shohim vendime të marra nga ana e Kryetarit, dhe për çdo ditë shohim edhe anulime të vendimeve. Kryetar, a po gabon qëllimisht, apo dikush qëllimisht po ju këshillon të gaboni. Kështu në këtë mënyrë vepruat edhe në konkursin e fundit në arsim, ku sipas dokumenteve të publikuara, së pari keni pranuar personin në punë e pastaj keni hapur procedurat, kjo ndodh vetëm në Vushtrri dhe vetëm në qeverisjen e juaj. Me të vërtetë Kryetar jeni një shembull për tu mos u ndjekur!

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-duke ju referuar diskutimit të parafolësit ceku se dëshiron ti informoj qytetarët se vërteta e shpenzimit të buxhetit të komunës në investime kapitale nuk është

16%, por 48 % kjo është e vërteta. Investimet kapitale që janë duke ndodhur në Qytetin e Vushtrrisë dhe në rrethinë do shënjojnë gjurmë të pashlyeshme, sepse janë projekte të cilat do të ia ndërrojnë pamjen qytetit për të mirë. Tutje shtoj se në qeverisjen e tij konsulentët i ka marr në punën përmes procedurave të prokurimit dhe janë perona me eksperiencë si p.sh z.Haki Merovci, është marr në pozitën e shefit të protokollit për të vu rend në protokollin e komunës dhe i njëjti ka pasur kontratë një vjeçare. Lidhur me pretendimin se e ka marr në punë shoqen e tij, sqaroi se ajo ka qenë e punësuar në Ministrinë e Arsimit, në pozitën shefe e Divizionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe e njëjta është njohëse shumë e mirë e politikave të BE-së, dhe ka qenë pjesë e ekipit për njohjen e diplomave mes gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimorë. Në këtë kontekst shtoj se është ajo që i ka organizuar takimet me agjencitë që investojnë nëpër vendet e ndryshme, dhe kjo mund të dëshmohet për secilën me raport. Pastaj shtoj se ai është i hendikepuar sepse vërtet ka një staf të kufizuar, e që ka nevojë të merr staf shtesë për ti kryer detyrat. Lidhur me bordin e NPL. "Përparimi" ceku se atë bord e ka zgjedhur Komisioni i Aksionarëve. Po ashtu ai përsërit se nuk dëmtohet buxheti i komunës duke shkuar nëpër seminare dhe duke marr ndonjë mëditje, por ai dëmtohet nëse kemi projekte korruptive.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –duke replikuar tha se buxheti është duke u shpenzuar por a janë duke u kryer punët, apo ndoshta po kryhen pagesa pa u kryer punët.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-njoftoj se me datën 25 të muajit të kaluar është hapur fushata 16 ditë aktivizëm kundër dhunës në baza gjinore dhe nga ajo ditë çdo komunë në forma të ndryshme po e promovon këtë fushatë më qellim parandalimin e dhunës në baza gjinore. Fatkeqësisht në komunën tonë ky fenomen ka rritej çdo vit, ku vetëm këtë vit janë raportuar në polici 79 raste dhe vetëm një nga këto rastet është e komunitetit rom. A qëndrojmë keq ne si institucion sa i përket kësaj çështje kjo është po dhe kjo është negative, sepse në të kundërtën nuk do të rritej si fenomen.si komunë duhet të punojmë më tepër për ta forcuar zingjirin institucional për ta mbrojtur viktimën e për ta dënuar dhunuesin. Komuna i k disa mundësi që të ndihmoj në këtë aspekt të cilat i numëroj: në aspektin afatgjatë komuna duhet të ndërtoj një strehimore për viktimat e dhunës në baza gjinore, sepse ekziston një qendër e tillë në Mitrovicë, por me kushte të mjerueshme. Në aspektin afatshkurtër komuna duhet ta takoj drejtoreshën e Qendrës Strehimore aktuale në Mitrovicë dhe ta ndihmoj këtë qendër brenda kapaciteteve dhe mundësive që ka për ti ndihmuar viktimat nga Komuna e Vushtrrisë. Duhet të gjendet mundësia ligjore nga DSHPS-ja që të kompensohen punëtorët social për kujdestarit e tyre, sepse kjo i ndihmon viktimat që në ndodhi e tyre mos të presin gjatë kohë për tu strehuar. Nga dhuna mbi baza gjinore nuk afektohen vetëm femrat-gratë por dhuna dhe problemet psikologjike përçohen edhe të fëmijët e rrjedhimisht tek familja tek rrethi, shoqëria edhe tek gjenerata e ardhshme. Prandaj apeloj për një unifikim dhe për përpjekje të përbashkëta për ta parandaluar këtë fenomen.

Lorik Maxhuni, drejtor i DSHPS-njoftoj se është nxjerr vendimi për kompensimin e kujdestarive për punëtorët social dhe nga muaji janar pritet të zbatohet vendimi për kompensimin e këtyre kujdestarive. Pastaj informoj se në kuadër të QPS në Vushtrri është duke u bërë përpjekje maksimale që të adresohen rastet e dhunës mbi baza gjinore, e për të cilën qendër u zotua se nuk do të mungoj ndihma nga ana e komunës.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-propozoi që në kuadër të rendit të ditës të futet edhe një pikë shtesë që ka të bëjë me financimin e një libri për periudhën e luftës 1998-1999 lidhur me Batalionin e I të Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës, për këtë libër janë mbledhur shënime argumente nga lufta, përfshirë dokumente por edhe ditarë e eprorëve të UÇK-së, autori ka kërkuar mbështetje financiare edhe Nga Ministria e Kulturës, që i është afruar një ndihmë simbolike. Libri ka për qëllim të ndriçoj luftën çlirimtare duke përfshirë luftën aksionet, suksese, sfidat dhe humbjet

në beteja që janë zhvilluar në këtë zonë. Përmes këtij libri do të hedhet dritë mbi të vërtetën e luftës sonë të drejt në territorin e Batalionit të parë të B.142 të UÇK dhe autor i librit është z.Gëzim Saraçi. Në emër të autorit kërkoj që të futet në rend ditët propozim-vendimi për ofrimin e ndihmës financiare për botimin e këtij libri.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit –njoftoi se para disa ditësh doli në publik edhe një listë e përfitimeve me grante dhe subvencione në vlerë prej 103,000.00 €, por edhe me disa shtesa tjera kjo vlerë shkon në 300,000.00€ që janë ndarë nga Komuna e Vushtrrisë, që nuk dihet nga cili fond por që është dedikim për OJQ-të. Kur e merr për bazë këtë shumë kaq të konsiderueshme, që është ndarë dhe kujton se kemi lagje të tëra pa ujë të pijes dhe pa kanalizim vërtet është për të ardhur keq. Më tej kujtojmë se nuk kemi transport publik për shumë fshatra si p.sh fshati Sllakoc, ndërsa bileta në një drejtim është 1 € ndërsa për vajtje ardhje është 2 € nëse llogaritet për 22 ditë i bie 44 € për një person apo nxënës nëse një prind ka dy fëmijë në shkollë atëherë ai e ka të pamundur të mbuloj shpenzimet e transportit për fëmijët e tij. Klubet sportive si OJQ kanë përfituar vetëm 40,000.00 € apo 13 % të shumës totale të shumës për subvencionin e OJQ-ve dhe kjo tregon se kjo qeveri nuk e ka qëllimin të mbështet rinin e sportin por individ të caktuar. Pastaj ka që janë subvencionuar grupe joformale, dhe për këtë pyeti se cila është veprimtaria dhe çka janë grupet joformale. Tutje njoftoi se ka OJQ që ka përfituar 38,000.00 € apo gati sa totali i përfitimit dhe subvencionimit të klubeve sportive dhe kjo është e tmerrshme. P.sh Shoqata e Veteraneve të Edukatës Fizike përfiton 12,000.00 € apo shprehur ndryshe sa paga e një mësuesi për dy vite. Pyeti se përse nuk subvencionohet Shoqata e Pedagogëve të Edukatës Fizike, ku bëjnë pjesë arsimtaret e edukatës fizike dhe këta kësisoj e kanë ndërpre veprimtarin e tyre në mungesë të mjeteve financiare dhe për pasoj të mos subvencionimit. Shkolla e Mesme “Gjimnazi” në Vushtri ka përfituar disa vend dhe medalje në nivel republikan dhe pyeti se këta nxënës dhe arsimtar të edukatës fizike që kanë kontribuar a iu është ndarë ndonjë ndihmë nga ana e komunës.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit–vlerësoi se kryetari i komunës me shumë pompozitet e paraqiti projektin dhe punimet në shesin e Qytetit të Vushtrrisë, por ai si duket nuk i ka llogaritur dëmet që është duke ia shkaktuar bizneseve dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Për këtë kryetari kishte premtuar se të gjitha bizneseve në kisosqe do tu bëj zgjidhje në një lokacion të ri, kjo lëre që nuk ka ndodhur por tashmë ato biznese janë mbyllur dhe njëra prej tyre nuk dihet se ku gjendet, këto dëme i kanë prekur edhe bizneset tjera që kanë vështirësi në qasje nga qytetarët për shkak të punimeve. Ky projekt i sheshit ka filluar pa një analizë të mirëfilltë, ku ndodhi që fillimisht u njoftua se do të ketë ndërprerje të ujit vetëm në dy apo tri rrugë por që uji u ndal në krejt qytetin për 3 ditë rresht, dhe përse nuk u vendos një cisternë me ujë për furnizim. Në fund ngrit një shqetësim lidhur me kontratën për rikonstruktimin e rrugëve ku po shtrohen dhe rinovohen rrugë vetëm në qytet dhe edhe pa nevojë vetëm e vetëm me qëllim të shpenzimit të buxhetit.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –pyeti kryesuesen e kuvendit sa a ka ndonjë konfirmim nga MAPL, lidhur me vendimin për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, sepse ai kundër këtij vendim ka ushtrua ankesë dhe akoma nuk ka marr përgjigje. Pastaj shtoi se kryesuesja e kuvendit ka për obligim që secilën pikë të rendit të ditës ta filtroj në zyrën ligjore. Lidhur me subvencionimin e OJQ-ve ceku se kryetari i komunës nuk ka ndonjë përgjegjësi sepse subvencionet janë dhënë nga MAPL-ja në masën 85% ndërsa vetëm 15% komuna.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës–duke u përgjigjur në pyetjet e ngritur nga anëtarët e kuvendit sqaroi se subvencionimi i OJQ-ve ka ndodhur nga një fond i Qeverisë Japoneze MPLS-së dhe me një participim të lehtë të Komunës së Vushtrrisë dhe anëtarët e komisionit kanë qenë nga Qeveria

e Kosovës, ndërsa një anëtar ka qenë nga shoqëria civile dhe në rastin konkret ai nuk ka kurrfarë lidhje dhe as që është interesuar se cilat OJQ kanë përfituar. Për transportin publik sqaroi se komuna nuk organizon transport publik sepse kjo ofrohet nga operatorët privat. Lidhur me garat ceku se anëtari i kuvendit i ngatërroj sepse kori i shkollës dhe recitalet janë në kuadër të plan-programeve të shkollave dhe nuk kemi të drejt të ekzekutojmë pagesa për këto aktivitet nga komuna. Pastaj shtoi dhe njoftoi se i ka shkruar një qytetar Kushtim Maloku, i cili është në hallë nga një trotuar i cili është ndërtuar në kohën kur ka qenë drejtor i DSHP z.Refik Mloku, sepse nga keq ndërtimi, grumbullohet uji dhe depërton në shtëpinë e këtij qytetari. Lidhur me projektin se sheshit sqaroi se projektet e mëdha kanë edhe efektet jo të mira fillimisht, por e vërteta është se ky projekt është në dobi të përgjithshme, e cili ngërthen në vete parkingun nëntokësor, amfiteatrin veror dhe dyqanet zejtare për ti akomoduar shitësit e rrugëve. Më tej njoftoi se në fillim të këtij projekti ka dal në teren dhe ka biseduar në mënyrë individuale me secilin biznes, që afektohet nga ky projekt, dhe njoftoi se në vijim do ta sjellë para kuvendit propozim-vendimin për ofrimin e ndihmës për këto biznese që janë prekur nga zhvillimi i punimeve në projektin e sheshit. Për ujin e pijshëm dhe ndërprerjet që kanë ndodhur sqaroi se gjatë gërryerjes dhe punimeve në shesh është hasur në një gyp të asbestit që është dashur të sanohet dhe tani ky problem është rregulluar.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit –njoftoi se në kohën kur ka qenë drejtor i Shërbimeve Publike, për një vit e gjysmë ka bërë 4200 kycje në rrjetin e ujës-jellësit, ndërsa kjo qeveri për dy vitet nuk mundur të bëjë as 42 kycje në rrjetin e ujës-jellësit.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-ceku është mirë që po rregullohen rrugët, por ajo e kishte fjalën për kontratën për rikonstruktim që po bëhet rinovimi i disa rrugëve, e në disa raste edhe pa pasur fare nevojë.

Feride Hysen, kryetare e Kryqit të Kuq të Kosovës- në adresim para anëtarëve të kuvendit falënderoj të gjithë për kontributin që kanë dhënë për vendimin e marr nga Kuvendi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të ri të Kryqit të Kuq në Vushtrri.

Abdullah Vojvoda, kryetar i kryqit të Kuq Në Vushtrri- në adresim para anëtarëve të kuvendit falënderoj të gjithë për kontributin që kanë dhënë, për adresimin e nevojës për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq në Vushtrri.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-propozoi të procedohet në rend dite propozim-vendimi për faljen e obligimeve tatimore në pronën e paluajtshme, për vitin 2023, dhe e përkrah propozimin për subvencionimin për botimin e librit, edhe pse është dashur të bëhet kërkesa me shkrim dhe të shikohen mundësitë financiare për ndihmë si dhe të përfillen filtrat dhe procedurat ligjore.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – propozoi të procedohet në rend dite propozim-vendimi ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Engjëll Grabanica. Për këtë ndihmë është bërë kërkesa në formë të rregullt dhe i njëjti vuan nga një sëmundje e rënd kancerogjene. Propozoi që ti ndahen ndihmë në vlerë prej 5000 €.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – propozoi të procedohet në rend dite propozim-vendimi, për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete, pasi që siç është njoftuar, një anëtar i kuvendit nga radhët e LDK-së ka kaluar në PDK dhe tani duhet të bëhet zëvendësimi edhe në komitet, pra fjala është për anëtarin e kuvendit z.Behar Duraku.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –tha se ka qenë propozim i Qeverisë Kurti, që si masë lehtësuese ndaj qytetarëve të falën obligimet tatimore në pronën e paluajtshme deri në 100 € për vitin 2023. Por si duket kryetari i komunës për të marr poenë politike para rendit të ditës ngarendi për ta propozuar këtë pikë të rendit të ditës. Më tej rikujtoj se kryetari i komunës në takimin në Asociacionin e Komunave me Kryeministrin e Kosovës, ka dal në deklaratë për media ku ka kundërshtuar një veprim të tillë për këto obligime tatimore duke e quajtur të palogjikshëm, vështirë

të zbatueshëm dhe të cilin Komuna e Vushtrrisë nuk do ta zbatoj. Në këtë rrafsh vlerësoi se është mirë të mos propagandohet dhe të kemi ndryshim të qëndrimeve nga ana e kryetarit të komunës.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se kur flasim për korrektësi atëherë edhe duhet të jemi korrekt dhe shtoj se është e filmuar me video deklarimi i tij ku ka thënë se ky vendim është i jashtë logjikshëm dhe këtë e ka vërtetuar edhe Gjykata Kushtetuese, sepse vendimi i Ministrisë së Financave për këto obligime është i palogjikshëm sepse për këtë çështje mandatar janë kuvendit komunale dhe këtë e ka vërtetuar Gjykata Kushtetuese.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –tha se i takon kuvendit të komunës që të marr vendim për faljen e këtyre obligimeve tatimore dhe jo kryetarit të komunës, lidhur me kontratën kolektive të arsimit vlerësoi se për këtë duhet të marrin përgjegjësi ministrat e arsimit që kryesisht kanë qenë nga radhët e PDK-së, që kanë ndëshkuara këto kontrata duke i dëmtuar financiarisht Komunitet e Republikës së Kosovës.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –tha se e mbështet propozimin e kryetarit të komunës, për faljen e obligimeve tatimore deri në 100 €, për vitin 2023. Më tej vlerësoi se nuk duhet tentuar për të marr primat për ta bërë këtë propozim sikurse po tenton shefi i grupit kuvendar të LVV-së. Më tej duke ju referuar Ligjit për Ndërmarrjet Publike, propozoi që të futet në rendin e ditës shkarkimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes së Uniteti, pasi që ky komision ka dështuar në përmbushjen e obligimeve ligjore detyrave dhe që përgjegjësit që i ka me ligj.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se propozimi për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitet nuk ka bazë ligjore dhe si i tillë nuk duhet të futet në rendin e ditës.

Behar Duraku, anëtar i kuvendit –lidhur me propozimin për shkarkimin e tij nga Komitetit për Komunitete, ceku se nëse z.Lahu, mundet të ndikoj që në MAPL apo në KQZ të ia ndërroj subjektin politikë atëherë ai është i gatshëm vullnetarisht të jap dorëheqje nga kjo pozitë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –tha se nëse nuk futet në rendin e ditës propozimi për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitet, atëherë grupi kuvendar i LDK-së do ta lëshojë seancën e kuvendit.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –tha se pajtohet me kërkesën e z.Lahu, se anëtari i kuvendit Behar Duraku, në mënyrë vullnetare ose duhet të jap dorëheqje nga komitetit për komunitete ose duhet të hedhet në votim, sepse ashtu siç ia ka dhënë mandatin në komitet kuvend ashtu edhe ka të drejt të ia marr këtë mandat. Ndërsa z.Duraku i takon moralisht të jep dorëheqje nga pozitat e Komitetit për Komunitete.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendi në mënyrë të veçantë i hodhi në votim pika e propozuar në ndryshme për inkorporim në rendin e ditës dhe atë me sa vijon:

Kuvendi me vota “unanime” e inkorporoj në rendin e ditës Raportin për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore në Komunën e Vushtrrisë për periudhën shtator-nëntor 2023.

Me vota “unanime” kuvendi e inkorporoj në rendin e ditës Propozim-vendimin për rishqyrtimin e vendimit të kuvendit për inicimin e hartimit të PZHK-së.

Me vota “unanime” kuvendi e inkorporoj në rendin e ditës Propozim-vendimin për faljen e obligimeve tatimore në pronën e paluajtshme.

Me 30 vota “për” 1 votë “abstenim” kuvendi e inkorporoj në rendin e ditës Propozim-vendimin për ofrimin e ndihmës financiare për botimin e librit “Artakolli në ecej motesh ” të autorit Gëzim Saraçi.

Me vota “unanime” kuvendi e inkorporoj në rendin e ditës Propozim-vendimin për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Engjëll Grabanica.

Me 9 vota “për” 19 vota “kundër” 1 votë “abstenim” kuvendi nuk e inkorporoj në rendin e ditës Propozim-vendimin për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitet z.Behar Duraku.

Pas votimit të kësaj pike të rendit të ditës shumica e anëtarëve të grupit kuvendar të LDK-së në mënyrë demonstrative e lëshuan sallën e mbledhjes.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për” dhe 2 vota “abstenim” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 tetor 2023;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. “Përparimi” SH.A për vitin 2022;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për caktimin e normave tatimore të pronave;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale;
6. Shqyrtimi i Informatës për menaxhimin e mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për faljen e obligimeve tatimore në pronën e paluajtshme;
9. Shqyrtimi Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për botimin e librit “Artakolli në ecej motesh ” të autorit Gëzim Saraçi;
10. Shqyrtimi Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Engjëll Grabanica;
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rishqyrtimin e vendimit të kuvendit për iniciimin e hartimit të PZHK-së;
12. Shqyrtimi i raportit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore në Komunën e Vushtrrisë për periudhën shtator-nëntor 2023;
13. Pyetje dhe përgjigje;

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 tetor 2023;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me 21 vota “për”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 tetor 2023.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. "Përparimi" SH.A për vitin 2022;

Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit – duke iu adresuar kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, dhe duke trajtuar raportin e Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. "Përparimi" SH.A për vitin 2022 të cilin e cilësoi si raport të përgjithësuar dhe skandaloz andaj deklaroi duke shtruar pyetjen se a e dini se në Komunën e Vushtrrisë kositet bari edhe në dimër? Komuna e Vushtrrisë ka "kositur" 53 787 Euro të buxhetit të vitit 2022, përmes kositjes së barit gjatë stinës së dimrit në hapësirat publike, në oborret e shkollave dhe në Qendrat e Mjekësisë Familjare nëpërmes Ndërmarrjes "Përparimi" gjatë muajve të dimrit, ku për 1 metër katror u pagua sipas Marrëveshjes 0.09 cent! Në janar 2022 u kositen 25 000 metra katrorë bari dhe u pagua 2250 Euro, në ndër kohë trotuaret pastroheshin nga bora! Në shkurt 2022 u kositen hiq më pak se 82 616.50 metra katrorë bari dhe u paguan 7435 Euro! Në mars 2022 hiq më pak se 107 554.10 metra katrorë bari dhe u paguan 9679 Euro! Në prill 2022 u kositen 93 632 metra katrorë bari dhe u pagua 8426 Euro! Në tetor 2022 u kositen 92 925 .28 metra katrorë bari dhe u paguan 8363 Euro! Në nëntor 2022 u rrit bari më shumë se në tetor prandaj u kositen 109 608.89 metra katrorë bari dhe u paguan hiq më pak se 9864 Euro! Në dhjetor 2022 u kositen 86 335.12 metra katrorë bari dhe u paguan 7770 Euro! Në total gjatë këtyre muajve jo karakteristik për kositjen e barit u pagua hiq më pak se 53 787 Euro! Në të njëjtët muaj janë paguar edhe qindra Euro për prashitje të drunjtëve dhe ujitje të luleve! Më tej shtoj se raporti i auditori për pasqyrat financiare të kësaj ndërmarrje ka konstatuar se implikon gabime në aspekte materiale për shkak të gabimit dhe mashtrimit. Kjo tregon se ka pasur mlaverzime financiare në menaxhimin e kësaj ndërmarrje. Çka duhet me ndodhë këtë vend më shumë për të filluar hetimet drejtësia në Kosovë?!

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –duke ju referuar raportit në fjalë, ceku se është mirë që kjo ndërmarrje është duke bërë në punë të mirë, dhe duhet të bëjmë përpjekje të përgjithshme për ta përmirësuar gjendjen në këtë ndërmarrje, për ta përmirësuar gjendjen e punëtorëve në krijimin e kushteve më të mira për ta në rritjen e pagave e të ngjashme. Fokusi ynë duhet të jetë në riorganizimin e kësaj ndërmarrje në ngritjen dhe zgjerimin e shërbimeve të saj dhe kualitetin në ofrimin e tyre për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Pretendimi sa ka pasur kositej në muajit e dimrit, është sakat për faktin se mirëmbajtja dhe kositja e varrezave duhet të bëhet edhe gjatë stinës së dimrit. Është mirë që janë procesverbale dhe me këtë dëshmohet se edhe kur kanë qenë në opozitë nuk e kemi kundërshtuar punësimin, në mandatin e kaluar 160 persona janë punësuar me kontratë mbi veprën dhe askush nga PDK nuk e ka kundërshtuar këtë sepse në fund të fundit të gjithë ata kanë qenë qytetar të kësaj komune.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –duke ju referuar pikës 4 të raportit shërbimet e mirëmbajtjes së hapësirave publike në Komunën e Vushtrrisë neni 14 deblokimi i kanalizimeve. Lidhur me këtë njoftoi se në shkollën fillore "Migjeni" në Stanofc të Epërm kanalizimi është i bllokuar për gati dy vite me radhë, andaj pyeti zyrtarët e kësaj kompanie se çfarë është ndërmarr për zhbllokimin e këtij kanalizimi. Pastaj tek aktivitetet e renditura gjatë muajit nëntor 2022 flitet për ujitjen e luleve në hapësirë prej 333.80 m² faqe 17 çmimi 0.80 € dhe pyeti se ku u gjenden lulet në muajin nëntor, sepse në vendet që i ka vizituar këto lule nuk shihen se ekzistojnë. Mandej tek rrathët në rrugën maxhistrale që janë mirëmbajtur nga komuna, përkatësisht "Përparimi", a ka pasur drejt ligjore të kërkohet kompensimi nga komuna, kur dihet fakti se ato pjesë menaxhohen nga Ministria e Infrastrukturës. Pastaj pastrimi i lumenjve "Tërstena" dhe "Podrança" ku shihet se ekzistojnë pagesa për çdo muaj për këtë aktivitet, që edhe mund të arsyetohet, por nuk mund të arsyetohet pastrimi i tyre për muajt korrik, gusht dhe shtator, sepse nuk ka pasur pastrim në këta muaj, ku

vlera totale financiare për këtë tre muaj është 49,134 € shpenzime për pastrim të lumenjve, kjo nëse shumëzohet për 0.30 € për metër katror i bie se është dëmtuar buxheti për 14.714 €. Sipërfaqja totale që është evidentuar në raport se është pastruar është 174.240.14 m², por realiteti është se në lagjen Tërstena nuk është pastruar fare sepse ai e viziton thuajse çdo ditë atë vend. Lidhur me sigurinë e punëtorëve të kompanisë, ceku se është jashtë çdo niveli duke marr për bazë se faqen zyrtare të komunës, shihen mjetet motorike të kësaj kompanie që nuk kanë fare tabela të regjistrimit.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –lidhur me investimet kapitale në këtë ndërmarrje nuk kemi të dhëna, ndërsa në procedura të prokurimit kemi përgatitje të specifikave për blerjen e makinerisë punuese, dhe shihet se janë blerë mjetet të motorike të punës të vjetruara që janë paguar me çmime shumë të shtrenjta. Prandaj vlerësoi se ky raport është materie që duhet të trajtohet dhe hetohet nga ana e prokurorisë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –tha se ky raport është vërtet skandaloz dhe i njëjti meriton të trajtohet nga ana e prokurorisë, dhe mjafton për këtë të ceket vetëm një fakt, raporti i auditorit të pavarur është i vitit 2021, kurse raporti i komisionit është i vitit 2022, pra mungon raporti i auditorit për vitin 2022 e që kjo parqet shkelje flagrante dhe si i tillë, dhe këtë do ta dërgojnë tek organet kompetent dhe do të bëjnë ankesë në MAPL sepse një gjë e tillë është skandaloze. Tutje shtoi se ky raport është dashur të nënshkruhet edhe nga anëtarët tjerë të komisionit të aksionareve e jo vetëm nga ana e kryesuesit z.Qemajl Hasani i cili është emëruar në këtë pozitë gjatë vitit 2022, e për të cilën periudhë raportuese ai nuk ka qenë në këtë pozitë. Ndër vendimet e para të këtij komisioni në fillim të vitit 2022 ishte shkarkimi i ish-Bordit të Ndërmarrjes me arsyetimin e mos bashkëpunimit dhe dështimit të tyre në përmbushjen e obligimeve dhe detyrave, por në esencë ky vendim ishte më tepër politikë. Pyetjet e tij ishin kush ishin anëtarët e bordit të shkarkuar, në qershor të vitit 2022, kush ishin anëtarët e bordit të përkohshëm të kësaj Ndërmarrje të emëruar në korrik të vitit 2022, kush janë anëtarët e bordit aktual, kur janë zgjedhur, cilat janë profesionet e tyre dhe sa është kompensimi i këtyre anëtarëve për punën e tyre. Në raport thuhet se bordi i përkohshëm i kësaj Ndërmarrje ka filluar punën në korrik të vitit 2022 dhe ka vazhduar punën për një periudhë 6 mujore deri në fillim të vitit 2023, gjatë kësaj kohe ky bord i përkohshëm a ka hartuar dhe a ka pasur strategji dhe planë gjithëpërfshirës të punës së ndërmarrjes sepse në raport nuk shihet se janë hartuar këto dokumente. A është bërë vlerësimi i punës të bordit të përkohshëm për vitin 2022 nga komisioni i aksionarëve sepse në raport nuk është paraqitur. Në faqen 19 shpenzimet e ndërmarrjes ceket se kemi pasur shpenzime për blerjen e mjeteve dhe pajisjeve dhe pyeti se cilat mjete dhe pajisje janë blerë gjatë kësaj periudhe, a janë blerë mjete të reja të punës, si kanë shkuar procedurat e prokurimit, sa është kostoja për secilën pajisje veç e veç dhe cila është gjendja teknike e këtyre mjeteve, sepse në bazë të informatave që posedojnë pajisjet janë të vjetruara dhe janë blerë me çmime shumë të larta.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-kërkoj nga kryesuesja e kuvendit të respektoj rregulloren e punës të kuvendit, për sa i takon kohës së diskutimeve, sepse nëse diskutohet në emër të grupit kuvendar atëherë përmbledhet i gjithë diskutimi edhe për anëtarët tjerë të po atij grupi ashtu që të racionalizohet koha në trajtimin e pikave të rendit të ditës. Lidhur me raportin e ndërmarrjes vlerësoi se krasitja e pemëve dhe drunjtëve dekorativ, bëhet në periudhën e përfundimit të vegjetacionit por edhe bëhet mbjellja e tyre, e që në këtë kontekst arsyetohet shpenzimi për krasitje dhe mbjellja të pemëve nga ana e Kompanisë “Përparimi”, gjatë muajve të dimrit. Lidhur me pagesat ceku se nuk do të lejon kurrë të bëhen pagesa pa u përfunduar punët dhe në këtë pikë është i prerë, nëse dikush ka lëshuar pagesa të tilla ai do të vjen para përgjegjësisë. Lidhur me mbështetjen financiare të “Përparimit” ceku se ajo do të jetë e vazhdueshme për ta fuqizuar këtë

kompani, për ti rritur pagat e punëtorëve dhe për ta bërë të njëjtën kompani të qëndrueshme. Lidhur me procedurat e prokurimit deklaroi se apeloj se kudo që keni dyshime atëherë ngitini tek organet kompetente, por mos i dërgoni çështjet tek prokurori pa i lexuar dokumentet, sepse ngjashëm e kishit denoncuar edhe mua si kryetar po ishte hedhur poshtë kjo lëndë nga ana z.Ymer Haradinaj i cili kishte dërguar lëndën tek prokurori. Në fund apeloj tek anëtarët e kuvendit që të vazhdojnë në mbështetjen e Kompanisë “Përparimi”, sepse e njëjta është duke bërë një punë të mirë, ndërsa shtoj se aty ku ka shkelje ngritin dhe dërgoni tek organet kompetente.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –kërkoj të fokusohet kamera në mbledhje edhe tek anëtarët e opozitës, sepse kjo vazhdimisht po ndodh që ata nuk po fokusohen qëllimisht. Ai deklaroi se kuvendit është i deputetëve dhe askush nuk ka të drejt ti ndaloj në shfaqjen e qëndrimeve të tyre, dhe demaskimin e të gjitha shkeljeve që ndodhin, ai njoftoj se nuk është deputet vetëm i fshatit Stanoc i Epërm, por i gjithë qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –duke ju referuar raportit në fjalë, shtoj se është mirë dhe sukses që ndërmarrja ka arritur brenda afateve të hartoj planin biznesor, me buxhet vjetor prej 81000.341.0.86 €, ndërsa shpenzime 723.916.040 €, e që i bie se ndërmarrja ka operuar me afarizëm të suksesshëm në vlerë prej 56,496 €, kurse tatim në fitim administratës tatimore i ka paguar në vlerë pre 6574 €, TVSH në administratën tatimore ka paguar 112,143.66 €. Më tej pasqyrat financiare ia nënshtruar auditimit të jashtëm, ku është konstatuar se pasqyrat financiare janë mbajtur konform parimeve dhe rregullave të standardeve të kontabilitetit. Në fund e përgëzoj komisionin e aksionarëve për punën që kanë bërë dhe për ofrimin e raportit para kuvend, në ç’ rast propozoi që i njëjti të aprovohet pa dallime.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –tha se këtë raport nuk po dihet a e ka hartuar anëtari i kuvendit z.Bekim Zabërgja, apo komisioni i aksionareve, por në esencë ky raport është politike, çka nuk do të duhej të ishte, më tej këtu u tha se kryeshefi i kësaj ndërmarrje është në LDK, kurse bazuar në ligj ai duhet të jetë peron zyrtar i pavarur politikisht, por nëse i njëjti është anëtar i LDK-së, ftoj Agjencinë Kundër Korrupsion të merret me këtë rast dhe të jap përgjigje se ka të drejt i njëjti të jetë kryeshef i kësaj ndërmarrje, duke qenë pjesë e një subjekti të caktuar politik. Më tej ai ngiti shqetësimin e tij për një deklaram të kryetarit të komunës për zotim për ngritjen e pagave për punëtorët e Përparimit që nuk e ka këtë të drejtë dhe shtoj se kur është marr vendimi për ngritjen e pagave është nxjerr vendim diskriminues me çka punëtorët janë ndarë në grupe ku kemi pasur dy vendime për dy kategori, ndërsa kategorisë së administratës nuk iu është ngritur paga dhe ata janë të shqetësuar. Pastaj në muajin maj 2023 udhëheqëseve të njësisive iu është ngritur paga në mënyrë shoqërore, nga ana e bordit të ndërmarrjes në bazë të një degës përmes adresës elektronike.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se do ti sugjeroj komisionit të aksionareve që të merret me çështjen e ngritjes së pagave për administratën e N.P.L. “Përparimi”, ndërsa e falënderoj lidhur me korrigjimin për sa i takon udhëheqësit të kësaj kompanie që duhet të jetë i pavarur politikisht në pozitën që e udhëheq.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 16 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoj Raportin e Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. “Përparimi” SH.A për vitin 2022.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për caktimin e normave tatimore të pronave;

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se në bazë të rekomandimit të Ministrisë së Financave, pronat që janë sipërfaqe prej 70-80 m² sipas kësaj formule mund të lirohen nga tatimi në pronë. Mandej

shtoj se si rezultat i krizës që po mbretëron edhe këtë vit të vazhdohet me normat tatimore sikurse në vitin e kaluar.

Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit –si grup kuvendar i LVV-së, kanë kundërshtuar rritjen e vlerës së normave tatimore, dhe kanë kërkuar që ato të jenë sikurse në vitin paraprak. Më tej përsëriti se kamerën mund të drejtoni kah do, por fokusin nuk mund të na largoni, sepse qytetari i dëgjon ato që i themi, pastaj duke ju referuar një zyrtari i cili nga zyra e partisë ka ardhur në zyrën e kuvendit, por këtu nuk mund të punohet sipas instruksioneve partiake sepse është kuvendit organi i institucionit të komunës ku përfaqësohen të gjithë, dhe nuk mund të bëhen këto dallime.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-tha se gjithëherë ka menduar se kamerat e vendosur në sallën e kuvendit, janë të instaluar në atë formë që në mënyrë automatike fokusohen nga ana kah vjen zëri, dhe sinqerisht nuk e ka ditur se i funksionojnë. Por me që ka ardhur debati deri në këtë pikë ku dyshohet se qëllimisht ato kamera hiqen nga fokusi i opozitës dhe z.Sylejman Meholli, atëherë ai propozoi që nga investimet kapitale të vendosen dy kamera ku në fokus të veçantë do ta kenë vetëm z.Sylejman Meholli. Në mandatin e kaluar kanë ekzistuar dy fotograf që kanë ndjekur seancat e kuvendit dhe asnjëherë nuk është fokusuar grupi kuvendar i PDK-së, por asnjëherë këtë nuk e ka thënë sepse nuk kanë vuajtur nga ai kompleks.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –tha se lidhur me këtë çështje është mirë të gjendet një modus i përbashkët, sepse tatimi në pronë i prek të gjithë qytetarët pavarësisht dallimeve, por e vërteta është se si komunë jemi me norma më të larta se sa komuna tjera, andaj propozoj që mos të rriten këto norma tatimore për shkak të gjendje që po mbretëron në kushte aktuale të krizës dhe inflacionit. Nëse shkohet me 0.25% do të dëmtohem si qytetar të Komunës së Vushtrrisë dhe kjo p.sh. nëse një ekonomi familjare ka paguar 100 € tani ai me 0.25% do të paguaj 125 €, ose bizneset nëse ka paguar 1000€ ai tani duhet të paguaj 1250 € dhe kjo është dëm që po shkaktohet. Kërkoj të bëhet një pauzë ashtu që të gjendet një zgjidhje e përbashkët.

Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit –tha se mbështet propozimin dhe si grup kuvendar janë që ulën normat tatimore me qëllim të ndihmesës së qytetarëve në këto kohë të rënd për ekonominë tonë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se ideja e z.Faton Hyseni është e qëlluar, që të ulën koeficiente e tatimit, kjo për faktin se vlera e objekteve afariste është shumë më e lartë se sa ajo e objekteve të banimit. Për afarizëm është propozuar 0.21 % ndërsa 10-13 %. Andaj propozoi që të aplikohet një tarifë prej 0.15% për të gjitha kategoritë, ky do të ishte një koeficient real për pronat afariste, ato rezidenciale dhe për të gjitha kategoritë. Kjo do të ishte edhe e përbalueshme dhe do të krijonte të hyra solide për Komunën e Vushtrrisë.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime lidhur me normat e tatimit në pronën e paluajtshme, tutje shtoj dhe vlerësoi se edhe me propozimin aktual por edhe me këtë tani nuk kemi rritje të normave tatimore dhe për këtë ilustruj edhe shembuj nga zonat e ndryshme të qytetit.

Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit –vlerësoi se do të ishte mirë të kemi një ulje të normave të tatimit në pronën e paluajtshme por duke dalluar pronat rezidenciale nga pronat komerciale, ashtu që të bëhet një ekuivalentim sipas kategorive dhe ashtu të bëhet më pas zbritja lineare e koeficienteve.

Kryesuesja e kuvendit konstatoj se pas konsultave që kanë pasur grupet kuvendare është vendosur të jenë sipas vendimit të vitit paraprakë, me qëllim të mos rendimit të gjendjes së qytetarëve.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 21 vota “për” 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet caktimi i normave tatimore për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, dhe atë si në vijim:

Lloji i pronës	Norma e tatimit në %
Pronë rezidenciale (banesë-apartament)	0,15
Njësi rezidenciale-parcelë	0,15
Pronë rezidenciale - shtëpi	0.15
Pronë komerciale	0.21
Njësi komerciale-parcelë	0,18
Pronë industriale	0.18
Njësi industriale-parcelë	0,18
Pronë bujqësore	0.15
Njësi bujqësore-parcelë	0,15
Njësi pyjore parcelë	0,15
Pronat e pa-meremetuara dhe jo të gatshme për banim	0.15
Garazhet	0.15
Objektet e braktisura	0.15
Pronat komerciale (pishinat, fushat sportive etj).	0.21
Pronat e pa-meremetuara dhe jo të gatshme komerciale	0.20

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
3. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal;

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –tha se kjo informatë vërtet është shumë e cektë dhe nuk i ka elementet e një informate gjithëpërfshirëse. Më tej njoftoj se në Komunën e Vushtrrisë ekziston një numër i madh i pronave dhe lokaleve afariste të cilave iu ka skaduar kontrata, e për të cilat qeveria komunale nuk ka ndërmarr asnjë veprim për renovimin e këtyre kontratave. Prandaj kjo informatë është dashur të bazohet në raportin e Komisionit për Verifikimin e Pronës Komunale, e sidomos është dashur të silllet në kuvend raporti për pronat në Gracë në sipërfaqe prej 6 hektar që janë dhënë në shfrytëzim dhe në cilat nuk ka ndodhur investimi e të cilat prona duhet ti kthehen Komunës së Vushtrrisë. Pastaj kemi rreth 50 lokale afariste të cilave iu ka skaduar kontrata për më tepër se dy vite dhe askush nuk është marr me këtë çështje. Kërkoj që raportet e punuara nga komisioni i pronës të sillen në kuvend dhe të gjendet një zgjidhje lidhur me pronat që janë dhënë në shfrytëzim e të cilave iu ka skaduar kontrata.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –tha se është mirë që të gjendet një zgjidhje një formë e duhur e përshtatshme, që prona të jepen në shfrytëzim me një çmim sa më të arsyeshëm por jo që e dëmton komunë, ashtu që gjitha pronat të jepen në shfrytëzim të zhvillojnë afarizëm dhe në anë tjetër komuna të gjeneroj të hyra financiare dhe kështu të ndodh zhvillimi. Ajo çka nevojitet të ketë një trajtim urgjent është situata që e kemi ku 50 lokale afariste paguajnë më tepër se 17,000.00€, ndërsa ka biznes që vetëm për një muaj paguan kështu shumë të qirasë dhe ko është e pa tolerueshme. Në fund tha se këto gjëra duhet të bëhen transparente ashtu që kemi një zgjidhje dhe mos të dëmtohet interesi i përgjithshëm i komunës.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –njoftoj se lidhur me këtë çështje komisioni ka hartuar dy raportet për pronat dhe dhënin e tyre në shfrytëzim dhe një raport tjetër për pronat në fshatin Gracë. Ndërsa këto raporte do të vihen para kuvendit mbledhjen e ardhshme për aprovim. Kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet dhe mbledhjen e ardhshme në mënyrë të detajuar do të informohet kuvend me pronat që janë dhënë shfrytëzim dhe atyre të cilave iu ka skaduar kontrata.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –falënderoj Drejtorin e Kadastrit për punën që ka bërë në zgjidhjen e një rasti dhe për punën e tij të mirë në përgjithësi.

Remzi Ahemeti, drejtor i DGJKP-së- paraqiti sqarime lidhur me çështjet e ngritur nga anëtarët e kuvendit.

6. Shqyrtimi i Informatës për menaxhimin e mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë;

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për faljen e obligimeve tatimore në pronën e paluajtshme;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim falën obligimet nga tatimi në pronën e paluajtshëm në Komunën e Vushtrrisë për ekonomitë familjare dhe bizneset në vlerë deri në njëqind (100 €) euro për vitin 2023.

2. Falja e obligimeve të cekura në pikën një (1) të këtij vendim, aprovohet pas publikimit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, me të cilin iu jepet e drejta kuvend komunale, për faljen e këtyre obligimeve, si dhe duke marr për bazë gjendje e renduar ekonomiko-sociale të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, si rezultat rritjes së çmimeve në treg-inflacionit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

4 . Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për botimin e librit “Artakolli në ecej motesh ” të autorit Gëzim Saraçi;

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- propozoi që vlera e subvencionit të jetë 5000 €, nga kategoria subvencione dhe transfere. Ndërsa shtoi se nëse nuk ka mjetet për këtë vit atëherë gjysma e vlerës do të mund të ndahej vitin e ardhshëm.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se është pro që të mbështet çdo punë e mirë por gjithherë duhet të përfillen procedurat, ashtu që është dashur të shikohet mundësia se sa kemi mjete financiare në dispozicion. Për këtë çështje është dashur që autori të bëj kërkesë me shkrim.

Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit –duke parë mundësitë buxhetori propozoi që për hartimin e këtij libri autorit t'i ndahen 2000 €.

Në fund të diskutimeve kryesuesja i hodhi në votim dy propozime njëri që të ndahen 5000 € për botimin e këtij libri, propozim i cili mori 4 vota “për”, ndërsa propozim tjetër që të ndahen 2000 €, mori 12 “për” dhe 2 vota “abstenim”

Nga të cekurat më larët u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim z.Gëzim Saraçi, zyrtar komunal në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, i ofrohet përkrahje financiare në shumë prej dymijë euro (2,000.00 €) për realizim të projektit botimi i librit “Artakolli n’ ecje motesh” kushtuar luftës të Batalionit të parë (parë) I të Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

2. Mjetet financiare të cekur në pikën paraprake të këtij vendim do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe në drejtoritë tjera komunale ku ka mjete të lira.

3. Përfituesi mjeteve financiare nga pika 1 e këtij vendimi duhet të dorëzoj në komunë – Drejtorinë për Buxhet dhe Financa brenda 7 ditësh pas përfundimit të projektit raport kthyes për shfrytëzimin e subvencionit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorit tjera kompetente komunale.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

10. Shqyrtimi Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Engjëll Grabanica;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –tha se më që gjendje shëndetësore e Engjëll Grabanicës është tejet e rënduar, kërkoj që shuma e ndihmës financiare të rritet në 7000 €.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-njoftoi se ka biseduar me organizatorët për ofrimin e ndihmës financiare për Engjëll Grabanicën, dhe ata kanë konfirmuar se shuma prej 5000 € për momentin është e mjaftueshme, andaj konsideron se duke parë mundësitë buxhetore të ndahet vlera prej 5000 €.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim z. Engjell Grabanica , i ofrohet mbështetje financiare në shumë prej pesë mijë euro (5000.00 €) për nevoja të shërimit i cili vuan nga një sëmundje e rëndë kronike.

2. Mjetet financiare të cekur në pikën paraprake të këtij vendim do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe në drejtoritë tjera komunale aty ka mjete të lira nga po e njëjta kategori buxhetore.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtorit tjera kompetente komunale.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rishqyrtimin e vendimit të kuvendit për iniciimin e hartimit të PZHK-së;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim fillohet hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) për Komunën e Vushtrrisë.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i Planifikimit Hapësinor-Plani Zhvillimor Komunal në harmoni me ligjin si: “Plan Strategjik multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me Planin Zhvillimor Komunal, nga neni 1 i këtij Vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësit për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor të Komunës së Vushtrrisë , plotëson kërkesat ligjore për të përgatitur Planin Strategjik multi-sektorial , i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

Neni 4

Kufiri i territorit

Zonat Kadastrale në territorin e komunës së Vushtrrisë të përfshira janë:

Nr.	Emri i z. kadastrale	kodi i zonës	ha	ari	m ²
1	Balinc	70202002	282	41	52
2	Banjskë	70202003	358	63	37
3	Bequk	70202005	729	14	53
4	Bivolaku	70202006	301	44	92
5	Boshlani	70202007	423	2	33
6	Bruznik	70202009	329	81	53
7	Bukosh	70202010	582	71	59
8	Lumadh	70202011	192	76	41
9	Vesekofc	70202013	895	37	45
10	Vilanic	70202014	136	10	57
11	Vërnice	70202015	424	38	62
12	Vushtëri	70202016	1847	87	00
13	Gllavotin	70202017	262	15	21
14	Gojbulë	70202018	692	36	23
15	Dumnica e Epërme	70202019	696	96	79
16	Studime e Epërme	70202020	723	84	24
17	Stanofci i Epërme	70202021	809	73	33
18	Gracë	70202022	458	99	51
19	Gumnishtë	70202023	975	4	37
20	Dobërllukë	70202024	310	93	57
21	Dalaku	70202025	108	88	19
22	Dumnica e Poshtme	70202026	677	23	57
23	Studimja e Poshtme	70202027	440	96	3
24	Stanofci i Poshtëm	70202028	346	43	56
25	SYRACAK	70202029	447	19	59
26	Druar	70202030	819	20	55
27	Dubofci	70202032	987	60	52
28	Zhiliboda	70202033	470	30	63
29	Zagori	70202034	388	10	59
30	Liqeni-Jezera	70202035	416	30	73
31	Karaqë	70202036	304	9	1
32	Kolla	70202037	718	23	14
33	Kunovik	70202038	170	11	94
34	Kurillova	70202039	506	27	72
35	(Dumnica e Mesme	70202040	718	97	76
36	Mihaliq	70202041	117	132	0.65
37	Miraqë	70202042	271	76	88
38	Nedakoci	70202043	801	4.3	6
39	Novolani	70202044	727	83	19
40	Begaj	70202045	217	98	2
41	Maxhunaj	70202046	682	26	57

42	Akrashticë	70202047	415	56	61
43	Ashlan	70202048	449	10	44
44	Pantinë	70202049	484	38	31
45	Pasoma	70202050	633	86	21
46	Pestovë	70202051	426	36	69
47	Prelluzha	70202053	745	99	72
48	Rezniku	70202054	357	18	65
49	Popica	70202055	192	74	97
50	Samadrexha	70202056	1144	65	39
51	Skoqna	70202058	479	29	2
52	Skromë	70202059	692	70	78
53	Sllakofci	70202060	776	94	35
54	Sllatina	70202061	413	59	35
55	Gjytezë(Smrekonica)	70202062	424	37	73
56	Strofc	70202063	578	85	41
57	Taraxha	70202064	270	93	31
58	Tërllobuqi	70202065	373	32	35
59	Hercegovia	70202067	433	84	35
60	Cecelia	70202068	795	96	52
61	Shallci	70202069	724	17	34
62	Shlivovica	70202070	613	96	42
63	Shtitarica	70202071	179	77	5
64	Beqiqi	70215006	329	43	38
65	Galicë	70215013	443	35	38
		Gjithsej:	31429	22	39

Neni 5 **Subjekti përgjegjës për hartim**

Bartës i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal caktohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .

Neni 6 **Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim**

Mjetet për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrisë. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës.

Neni 7
Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor të hartojë në afat prej 12 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8
Konsultimet publike

Projekti i Planit Zhvillimor Komunal para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe shqyrtim publik, paraqitja e Planit Zhvillimor Komunal në shqyrtim publik dhe koha për dhënia e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallet përmes njoftimeve publike.

Neni 9
Afati i Vlefshmërisë

Dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal hartohet për periudhën kohore 8 (tetë) vjeçare.

Neni 10
Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit (PZHK) sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhë zyrtare të Komunës dhe së paku 3 Kopje të shtypura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11
Programimi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë në nenin 11 pika 1.3 të Ligji të për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

12. Shqyrtimi i raportit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore në Komunën e Vushtrisë për periudhën shtator-nëntor 2023;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –tha se përveç dëmeve në kultura bujqësore nga fatkeqësitë natyrore kemi edhe dëme në ekonominë familjare, përkatësisht dëmtim të shtëpive që për disa vite nuk kanë marrë kurrfarë kompensimi, andaj kërkoj që këto familje të kompensohen konform rregullativës ligjore. Më tej duke marrë për bazë bashkëpunimin me humanistin Halil Kastrati, ku

kanë qenë vitin e kaluar 9 familje të parapara që të përfitojnë pyeti se deri ku kanë shkuar procedurat lidhur me ofrimin e këtyre ndihmave për ndërtimin e këtyre shtëpive, sepse në bazë të informatave vetëm 3 shtëpi kanë filluar të rindërtohen.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-njoftoi se qeveria komunale është në koordinim me humanistin Halil Kastrati, dhe tri prej këtyre shtëpive janë në përfundim e sipër, ndërsa pjesa tjetër besojnë se do të përfundojnë shumë shpejtë.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovet raporti i Komisionit Komunal lidhur me Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë, për përdhën shtator-tetor dhe nëntor 2023.

2. Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, ka dalë në teren dhe ka bërë evidentimin e dëmeve të shkuara nga moti i ligë (vërshimet, zjarret dhe erërat e forta dhe nga qenët endacak) që kanë mbretëruar në periudhën e sipër cekur në Komunën e Vushtrrisë.

3. Komisioni i cekur më lartë ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe ka shqyrtuar kërkesat e qytetarëve dhe konform të gjeturave ka evidentuar dhe kalkulua shumat e mjeteve financiare të shkaktuara dëm në vlerë totale prej **23,488.00 €**, si në të mbjellat bujqësore e po ashtu edhe dëmet e shkuara në ekonomitë familjare dhe biznese këto të dhëna për dëmet janë të bashkangjitura në mënyrë tabelare në raportin e komisionit.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Vushtrrisë dhe po ashtu ky vendim i dërgohet edhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME).

6. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

13. Pyetje dhe përgjigje:

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –pyeti kryetarin e komunës se pas ndryshimit të statutit të komunës, ka qenë premtim i kryetarit aktual të komunës, formimi i Drejtorisë së Diasporës, andaj pyetja është se kur do formohet një drejtori e tillë. Pastaj kur do ta zbatoj kryetari vendimin e kuvendit të komunës lidhur me Zonën Ekonomike në Lumadh dhe shpalljen e konkursit për këtë zonë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –pyeti Drejtorin e Arsimit se keni mësimdhënës që punojnë pa kontrata të punës, sepse ka informata dhe ka parë një kontratë ku shkruan se afati i kontratës është deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi mjekësor, ndërsa kjo punëtoreshë tani më ka dalë në pension, të saktësohet se a kemi punëtor që punojnë pa kontratë nëse ka sa është numri i tyre? A janë gjitha shkollat e komunës të furnizuar me ujë të pijshëm? Pyetje për Drejtoreshën e

Administratës, a keni filluar ti paguani këshillat lokal dhe kryetarët e këshillave lokal dhe si do të paguhen pasi që jeni në fund të vitit? Drejtoreshën e Urbanizmit pyeti në fshatin Stanoc i Epërm për vitin 2023 kanë qenë të planifikuar të shtrohen dy rrugë me asfalt Rr. Salih Haradinaj dhe Rr.Hysen Hardinaj, të cilat veç kanë qenë të asfaltuara, nga informata që ka dhe në koordinim me këshillin e fshati janë dakorduar me Drejtorinë e Urbanizmit që këto metra katror do të zëvendësohen me rrugë tjera, për cilat rrugë bëhet fjalë që do të asfaltohen në vend të këtyre dy rrugëve tjera? Në fund pyeti kryetarin e komunës se kur do të kenë ujë të pijes qytetarët e Komunës së Vushtrrisë?

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –sugjeroi se çështja e mbështetjes financiare për botimin e librave duhet të rregullohet, dhe mos të sfidohet kuvendi me forma të tilla siç i patëm më herët. Kjo do të mund të zgjidhje duke formuar një komision profesional qoftë të historianëve, letërsisë apo të ngjashme. Si kuvend duhet të vendosim një standard që subvencionimi të bëhet përmes thirrjes publike, dhe jo të kemi favorizimi për dikë e dikush tjetër që ndoshta e meriton të mbetet pa mbështetje. Kjo çështje do të mund të zgjidhje edhe përmes një kontrate operator ekonomik i cili do merrej me shtypjen dhe botimin e librave e kontraktuar nga Komuna e Vushtrrisë.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –pyeti Drejtoreshën e Kulturës se a ka filluar rregullimi i nxehtësisë në palestrën e sportive “Afrim Bunjaku” në Samadrexhë, pasi kemi kërkesa të shumta, dhe pas rënies së temperaturave sportistët janë të detyruar ti ndërprejnë aktivitetet e tyre sportive, ndërsa kemi të bëjmë me një shumë modest për rregullimin e këtij problemi. Kjo konstatohet se komisioni i cili ka vizatuar palestrën ka vlerësues se bëhet fjalë për një shumë deri në 1000 € për rregullimin e kësaj nxehtësie. Nëse ka filluar të rregullohet kjo çështje deri ku kanë shkuar procedurat.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-lidhur me formimin e Drejtorisë për Diasporë, njoftoj se është në përfundim e sipër hartimi i organogramit sepse nevojitet përshkrimi detaj i secilës pozitë dhe themelimi i saj pritet të ndodh shumë shpejtë. Lidhur me shpërndarjen dhe furnizimin me ujë të pijes njoftoi se kanë dalë disa probleme të pa planifikuara, por është duke u punuar intensivisht për përfundimin e këtij projekti, për të gjitha vonesat iu kërkon falje qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Por çështjen e ujit kanë dalë disa problematika shtesë të cilat nuk janë paraparë më herët sidomos me pompat por edhe me procedurat e tenderimit.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-sqaroi se për rregullimin e nxemjes në palestrën e sportive në fshatin Samadrexhë është nënshkruar kërkesa nga ana e kryetarit të komunës dhe është proceduar në Drejtorinë e Prokurimit dhe mendohet se shumë shpejt do të rregullohet kjo problematikë.

Mbledhja përfundoi në ora: 16:30.

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit